

FJALA E DEPUTETIT LUÇIANO BOÇI

E ENJTE 27 JANAR 2022

Përcaktimet diskriminuese që dalin nga goja e përfaqësuesve tuaj politikë për studentët, nuk janë lapsuse mendore apo rastësi, por janë tregues të gjendjes suaj mendore pikërisht në raport me ata, që në nënvetëdijen tuaj janë armiqtë tuaj historikë të viteve '90, por edhe atyre të protestave, që u përmendën këtu para 2 vjetëve. Ata ju nuk i konsideroni fare, sepse mendohet që nga kjo marrëveshje të jenë ata përfituesit kryesorë, konviktet e tyre, këtë e tregon "Karta e studentit", që ka më pak vlerë se një letër higjienike, e tregon edhe gjendja e dhomave aktuale të studentëve, që u ngjasojnë dhomave të torturave të komunizmit.

Por kjo nuk është lojë studentësh, jo! Kjo është lojë milionash ndërmjet Bashkisë së Tiranës, Ministrisë së Arsimit dhe Qytetit Studenti. E them këtë, sepse Qyteti Studenti është pjesë e Kampusit Universitar. Për Kampusin Universitar flitet shumë, ndërkohë që Qyteti Studenti ka mbetur zona më e paprekur nga ndërtimet e larta të sulmit që i bën territorit Bashkia e Tiranës. Sigurisht, këtu fle "lepuri i madh", ku përzihen milionat e parave, që vijnë në formë grantesh, 9 milionë në fillim fare, dhe tani në formë huaje. Këtu nuk merret vesh ku është qeveria dhe ku është bashkia! U përmend nga kolegët e mi se u premtua ndërtimi i Kampusit, që nuk ka qenë premtim vetëm i qeverisë, por ka qenë edhe premtim i bashkisë. Duhet parë historia për të parë të vërtetën e këtyre marrëveshjeve, sepse gjatë frazës politike dëgjova të flitej për fazat: faza e parë, e dytë e kështu me radhë. Pse gënjeni? "Fazat" janë emërtime teknike, që kushtëzohen nga mënyra si qeveria gjermane alokon fondet, është thjesht term teknik, dhe angazhimi juaj me fazat në këtë rast nuk ka të bëjë fare. Faza juaj më e madhe është marrja e milionave. Do të hidhen 35 milionë euro për Qytetin Studenti. Por çfarë thotë historia: Në vitin 2015 Bashkia e Tiranës bëri konkursin ndërkombëtar për projektin urban "Thirrje për projekt", ky është studimi. Garën me kompanitë ndërkombëtare e fitoi një bashkim kompanish. Fituesi është shpallur në vitin 2015 (se flitet për kampuse, kërkohet kampusi, se ju nuk fshini as historinë dhe vendimet tuaja), ku do të hidheshin 72 milionë euro dhe koncesionari do të ndërhynte në projektet tregtare, me ndërtime të reja brenda territorit të kampusit, por kishte një pengesë, që ishin disa godina private atje. Historia vazhdon më pas me protestën studentore, kërkesën e tyre dhe angazhimin me Paktin për Universitetin, angazhimin e ngritjes së grupit ndërinstitucional, që e citoi zonja Zhupa, i cili do të merrej me situatën, me evidentimin e fakteve në terren dhe paraqitjen para Kryeministrit. Ky grup u ngrit në mars. Po çfarë ndodhi në nëntor të vitit 2019?!

Kryeministri Rama, pa marrë në konsideratë fare grupin ndërinstitucional, i jep të drejtën Bashkisë së Tiranës të japë me koncesion ndërtimin, administrimin, rinovimin e Qytetit Studenti, ia jep me VKM. Më pas, pa pritur edhe këtë gjë, vetë ai në janar ka paraqitur projektin e ndërtimit të kampusit universitar. Unë doja të ishte ministrja, Kryeministri, për të ditur: ku jemi, në ç'fazë? Në fazën e rikonstruksionit të Qytetit Studenti, apo në fazën e vazhdimit të projektit të kampusit universitar? Ku janë, ku shkojnë paratë? Si mund të bëhet një projekt ose rinovim i ndërtesave, kur projekti thotë krejt ndryshe. Ku hidhen paratë? E kërkuan kolegët e mi. Ku janë paratë? Ku është rezultati? Nuk ka rezultat. Ja, ky është kampusi! Është paraqitur projekti. A e kuptoni?! Doli vetë Kryeministri bashkë me kryebashkiakun, u hap para studentëve. Madje, iu referua e tha: "Ky projekt nuk është i ri, është i vitit 2015, por e pengonin disa godina". Godinat nr. 15 dhe nr. 18 që, në mos gaboj, u prishën në Qytetin Studenti. Sot ku jemi me situatën tjetër? Nuk e di as vetë Kryeministri, që e ka prezantuar projektin; nuk e di as Bashkia që ka një projekt. Më falni, jo se nuk e di, por e mban të fshehur. Qëllimi është të harxhohen lekë, 35 mijë euro nga xhepat e shqiptarëve, të rinovohen godinat me lekët e shqiptarëve dhe në fund ta marrë koncesionari, e ka gati, se bashkia e ka VKM-në. Situata është kaq e thjeshtë dhe

ngatërrimi në këtë rast bëhet me qëllim, pikërisht nga vetë Rama. Është edhe absurdi tjetër në buxhetin e vitit 2021. E dini se çfarë ka thënë ministrja e Arsimit në relacionin e komisionit tonë? “Qeveria shqiptare do të japë 500 milionë lekë”. E keni të shkruar, e zeza mbi të bardhë, do të japë 500 milionë lekë. Ja, ku është e printuar: “Për projektin për kampusin”. Oh, Zot, na ndihmo! Projekti ishte gati në vitin 2015, u miratua nga Kryeministri në vitin 2019, do të jepen edhe 500 milionë lekë. Ministrja e Arsimit nuk e di që ka projekt. Kryeministri, që bën buxhetin, e paraqet këtu. Nuk e ditka se ka projekt për kampusin, e ka miratuar dhe e ka prezantuar vetë! Duke mos ditur, këtu vjedhin, grabisin dhe 35 milionë euro të tjera. Përfundimi, pasi të hidhen këto para, sipas VKM-së, do të dalë një koncesionar që do të marrë territorin e Qytetit Studenti, sepse i tillë është projekti, që do të bëjë ndërtime tregtare, do të shtojë ndërtime të reja, edhe hoteleri, sepse kështu është parashikuar dhe Halelujah

Ja ku është skema e njëjtë, pothuajse e barabartë me skemën e inceneratorëve: ua marrin paratë shqiptarëve dhe ua japin atyre që konsiderohen oligarkë. Nuk ka rëndësi fare se kush e merr. Dihet se kjo lidhje po merr paratë e shqiptarëve për një rezultat që nuk ekziston në Qytetin Studenti. Ndiqni rrugën, ndiqni paratë që të gjeni krimin dhe kjo është e vërteta. Të tilla gjëra nuk ndodhin vetëm në arsimin e lartë. Studentët nuk janë në vëmendjen tuaj; në nënndërgjegje janë armiqtë tuaj, por, çuditërisht, edhe nxënësit vuajnë të njëjtën pasojë të mosvëmendjes së kësaj qeverie. Nuk e kam fjalën thjesht për atë mbylljen e atyre ditëve të acarta, që sot përfundoi, sepse unë e di shumë mirë se Ministria e Arsimit nuk ka plan, nuk ka strategji: po ra shi, e mbyllim shkollën; po ra borë, e mbyllim shkollën; po qe vapë, prapë e mbyllim shkollën; po ra pandemia, prapë e mbyllim shkollën. Ç’rëndësi ka shkolla?! Shkolla është e fundit, ndërkohë që një komb pa arsim vdes të ardhmen e tij dhe këtë e dimë. Për ta treguar, kam marrë një rast nga qarku im, është shkolla e Selviasit, në Mollas, që ka 300 nxënës dhe gjendja është katastrofale. Shkolla është e rrjepur nga lagështira, sepse nuk vihet dorë. Është vetëm 20 km larg Elbasanit dhe prindërit janë detyruar t’i heqin nxënësit nga shkolla që kanë afër për t’i çuar sa më larg. Kjo është gjendja e tarracës. Ndërkohë që sot flisni për 20 milionë euro borxh, që ka vajtur 80% borxhi, ja aplikimi, ja edhe tarraca! (Tregon foto.) Nuk bëhet fjalë për ditë të ftohta, por për ditë të zakonshme. Një vesë shiu po të bjerë, atje nuk bëhet mësim. Gjendja është katastrofale dhe kjo është e vërteta me ngjyra mbi të bardhë, sepse edhe të zezën mbi të bardhë ju e transformoni, por edhe ngjyrat mbi të bardhë ju i transformoni, i lyeni me mavi, sigurisht. Pra, kemi një marrëveshje të shkruar keq jo thjesht nga paaftësia, se unë e di sa lapidare është, po e shkruar keq, sepse ajo do të keqpërdoret dhe nuk do të vihet në funksion të studentëve, por në funksion të xhepave të qeveritarëve. Faleminderit!